



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**NJOFTIM PËR MEDIA**

Ditën e mërkurë, në datën 14 prill 2021, në mjediset e AMA-s, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Gentian</b>	<b>SALA</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Sami</b>	<b>NEZAJ</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Gledis</b>	<b>GJIPALI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Suela</b>	<b>MUSTA</b>	<b>Anëtar</b>

AMA pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. Miratimin e raportit të monitorimit të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të, për periudhën 04 prill – 11 prill 2021. (**Vendimi nr. 56, datë 14.04.2021**)
2. Përcaktimin e listës së subjekteve OSHMA që do të monitorohen për mbulimin e fushatës zgjedhore, në datat 12 prill 2021 - 20 prill 2021. (**Vendimi nr. 57, datë 14.04.2021**)
3. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “G2 Media” sh.p.k., për ndryshimin e përkohshëm të NLP-së së subjektit audioviziv “A2” nga numri NLP 77 në NLP 20. (**Vendimi nr. 58, datë 14.04.2021**)

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

**Tiranë, më 14.04.2021**